

LIGJ

Nr.9032, date 20.3.2003

PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE "KONVENTEN
NDERKOMBETARE PER VIJAT E NGARKESES" 1966

Ne mbeshtetje te neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqiperise aderon ne "Konventen nderkombetare per vijat e ngarkeses" 1966.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3777, date 16.4.2003 te Presidentit te Republikes se Shqiperise,
Alfred Moisiu

KONVENTA NDERKOMBETARE E VIJAVE TE NGARKESES, 1966

Qeverite Kontraktuese,
duke dashur te vendosin parime dhe rregulla uniforme lidhur me ligjet dhe kufijte, ne te cilat anijet ne udhetime nderkombetare mund te ngarkohen duke pasur parasysh nevojten per ruajtjen e jetes dhe pasurise ne del;
duke besuar se menyra me e mire per arritjen e ketij qellimi eshte konkludimi i nje Konvente,

kane rene dakord si me poshte:

Neni 1

Detyrime te pergjithshme te Konventes

1. Qeverite Kontraktuese marrin persiper te vene ne veprim kerkesat e kesaj Konvente dhe anekseve bashkengjitur, te cilat perbejne pjese te pandara te saj. Çdo referim i kesaj Konvente perben ne te njejten kohe edhe nje referim ndaj anekseve te saj.
2. Qeverite Kontraktuese do te marrin te gjitha masat qe mund te jene te nevojshme per venien ne zbatim te kesaj Konvente.

Neni 2

Perkufizime

Per qelimin e kesaj Konvente, nese nuk shprehet ndryshe:

1. "Rregulla" do te thote rregullat aneksuar kesaj Konvente.
2. "Administrata" do te thote qeveria e shtetit, flamurin e te cilit ka anija.
3. "I miratuar" do te thote i miratuar nga administrata.
4. "Udhetim nderkombetar" do te thote lundrim detar nga nje vend ku Konventa ne fjale eshte ne fuqi, ne nje port jashte ketij vendi ose anasjelltas. Ketu, konsiderohet si nje vend i vecante cdo territor per marredheniet nderkombetare, te te cilit ka nje Qeveri Kontraktuese, qe eshte pergjegjese ose per te cilin Kombet e Bashkuara jane autoriteti administrues.
5. "Anije peshkimi" eshte nje anije qe perdoret per zenie peshku, balenash, fokash, luane deti ose cdo lloj qeniesh te gjalla te detit.
6. "Anije ere" do te thote nje anije, fundi i se ciles eshte ndertuar ose qe eshte ne nje faze te ngjashme konstruksioni, ne ose mbas dates se hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente per secilen Qeveri Kontraktuese.
7. "Anije ekzistuese" do te thote nje anije qe nuk eshte anije e re.
8. "Gjatesi" do te thote 96% e gjatesise fatale ne vijen e ujit ne 85% te thellesise me te vogel te brendshme te matur nga maja e fundit ose gjatesia nga pjesa e perparme e sistemit deri tek aksi i boshtit te timonit ne kete vije uji, nese kjo eshte me e madhe.

Neni 3

Dispozita kryesore

1. Asnje anije, per te cilen kjo Konvente zbatohet, nuk do te dale ne det per te kryer nje udhetim nderkombetar pas dates ne te cilen kjo Konvente hyn ne fuqi nese nuk eshte kontrolluar, shenuar dhe pajisur me nje certifikate nderkombetare te vijave te ngarkeses (1966) ose, kur eshte rasti, me nje certifikate nderkombetare perjashtimi te vijes se ngarkeses ne perputhje me kerkesat e kesaj Konvente.
2. Asgje ne kete Konvente nuk e pengon administraten per te caktuar nje bord te lire me te madh nga bordi i lire i caktuar ne perputhje me aneksin 1.

Neni 4

Zbatimi

1. Kjo Konvente do te zbatohet per:
 - a) anije te regjistruara ne vende, qeverite e te cilave jane Qeveri Kontraktuese;
 - b) anije te regjistruara ne territore, tek te cilat kjo Konvente aplikohet sipas nenit 32;
 - c) anije te paregjistruara me flamurin e nje shteti, qeveria e te cilit eshte Qeveri Kontraktuese.
2. Konventa do te zbatohet per anijet qe angazhohen ne udhetime nderkombetare.
3. Rregullat qe permban aneksi 1 zbatohen ne menyre te vecante per anijet e reja.
4. Anijet ekzistuese qe nuk permbushin kerkesat e rregullave te aneksit 1 apo ndonje pjese te tyre duhet te plotesojne perkatesisht ato kerkesa minimale qe administrata zbaton per anijet ne udhetime nderkombetare perpara ardhjes ne fuqi te kesaj Konvente; ne asnje rast anije te tilla nuk do te kerkohen te rrisin bordin e lire. Me qellim qe te perfitohet nga

reduktime te bordit te lire nga ai i caktuar me pare, anijet ekzistuese do te permbushin te gjitha kerkesat e kesaj Konvente.

5. Rregullat e permbajtura ne aneksin 2 jane te zbatueshme per anijet e reja dhe ekzistuese, per te cilat kjo Konvente zbatohet.

Neni 5

Perjashtimet

1. Kjo Konvente nuk do te zbatohet per:

- a) Anijet e luftes
- b) Anijet e reja me gjatesi nen 24 metra (79 kembe)
- c) Anijet ekzistuese nen 150 ton bruto
- d) Jahte turistike te paangazhuara ne tregti
- e) Anijet e peshkimit

2. Asgje ne kete Konvente nuk do te aplikohet per anijet qe lundrojne vetem ne:

- a) Liqenet e medhenj te Amerikes se Veriut dhe lumit St. Lawrence deri ne nje vije ne forme rombi te hequr ne drejtim te lindjes, nga Cap de Rosiers ne piken perendimore, ishulli Anticosti dhe ne anen veriore te ishullit Anticosti, meridiani i gjatesise 63° ne perendim.
- b) Deti Kaspik.
- c) Lumenjte Plate, Parana dhe Uruguaj deri ne vijen ne trajte rombi te hequr ne drejtim te lindjes ndermjet Punta Rasa (Caba San Antonio), Argjentes dhe Punta del Este, Uruguaj.

Neni 6

Perjashtime

1. Kur anijet angazhohen ne udhetime nderkombetare ndermjet porteve fqinje te dy ose me shume shteteve, ato mund te perjashtohen nga administrata prej kerkesave te kesaj Konvente, per sa kohe qe do te mbeten te angazhuara ne udhetime te tilla, nese qeverite e shteteve ku keto porte ndodhen kane bindjen se natyra e mbrojtur apo kushtet e nje lundrimi te tille ndermjet ketyre porteve e bejne te paarsyeshme ose jopraktike zbatimin e kerkesave te kesaj Konvente per anijet e angazhuara ne keto lundrime.

2. Administrata mund te perjashtoje ato anije qe materializojne cilesi te nje lloji te ri, nga cdonjera prej kerkesave te kesaj Konvente, zbatimi i se ciles do te pengonte seriozisht punen kerkimore ne zhvillimin e cilesive te tilla, si dhe inkorporimin e tyre ne anijet qe angazhohen ne udhetime nderkombetare. Çdo anije e tille duhet megjithate te permbushet kerkesat e sigurise, te cilat ne opinionin e kesaj administrate jane te pershtatshme per sherbimin per te cilin eshte destinuar dhe jane te tilla qe te sigurojne ne pergjithesi sigurine e anijes dhe jane te pranueshme per qeverite e shteteve qe do te preken nga anija.

3. Administrata qe lejon perjashtime si ne paragrafin 1 dhe 2 te ketij neni, do t'i komunikojte Organizates Detare Konsultative Nderqeveritare (ketu me poshte e quajtur Organizata) hollesite e ketij perjashtimi dhe arsyet perkatese te cilat Organizata do t'ua qarkulloje Qeverive Kontraktuese per informim.

4. Nje anije, e cila nuk eshte normalisht e angazhuar ne udhetime nderkombetare, por, e cila ne rrethana te pazakonshme kerkohet te ndermarre nje udhetim te vetem

nderkombetar, administrata mund ta perjashtoj nga secila prej kerkesave te kesaj Konvente, me kusht qe ajo te permbush kerkesat e sigurise, te cilat, ne opinionin e kesaj administrate, jane te mjaftueshme per udhetimin qe ajo do te ndermarre.

Neni 7

Force madhore

1. Nje anije, qe nuk eshte subjekt i kerkesave te kesaj Konvente, ne kohen e nisjes se saj per udhetim, nuk do te behet subjekt i ketyre kerkesave ne rast devijimi nga udhetimi i planifikuar per shkak te kohes se keqe ose ndonje force madhore.
2. Ne zbatimin e kerkesave te kesaj Konvente, Qeverite Kontraktuese do t'i kushtojne kujdesin e duhur devijimit ose voneses se cdo anijeje per shkak te motit ose cdo lloj force madhore tjeter.

Neni 8

Ekuivalente

1. Administrata mund te lejoje perdorimin e nje konstruksioni, materiali, pajisjeje ose aparati, vendosjen e cdo lloj kerkese tjeter te ndryshme nga ajo qe kerkon kjo Konvente, nese bindet, nepermjet provave ose ne menyre tjeter, se kjo pjese, materiali, pajisje ose aparat apo kerkese eshte te pakten po aq efektive sa dhe ajo qe kerkohet nga Konventa.
2. Administrata qe lejon nje konstruksion, material, pajisje, aparat ose kerkese te ndryshme nga ajo qe kerkohet nga Konventa, do t'i komunikoj Organizates te dhenat perkatese per qarkullim Qeverive Kontraktuese, se bashku me nje raport te provave te bera.

Neni 9

Miratime per qellime eksperimentale

1. Asgje ne Konventen ne fjale nuk e ndalon nje administrate te beje miratime te vecanta per qellime eksperimentale, persa i perket nje anijeje, per te cilen kjo Konvente zbatohet.
2. Administrata qe ben nje miratim te tille do t'i komunikoj Organizates hollesite perkatese per qarkullim, Qeverive Kontraktuese.

Neni 10

Riparimet, ndryshimet dhe modifikimet

1. Nje anije qe i neshtrohet riparimeve, ndryshimeve, modifikimeve dhe perkatesisht nderrimit te pajisjeve, do te vazhdoje t'i permbush te pakten kerkesat qe zbatoheshin me pare per kete anije. Nje anije ekzistuese, ne nje rast te tille, nuk do t'u nenshtrohej kerkesave ne menyre me te pakte sesa u nenshtrohej me pare.
2. Riparimet, ndryshimet dhe modifikimet e nje karakteri madhor dhe nderrimi i pajisjeve ne keto raste, duhet te plotesojne kerkesat per nje anije te re aq sa administrata e shikon te arsyeshrne dhe praktike.

Neni 11

Zonat dhe rajonet

1. Nje anije, per te cilen kjo Konvente aplikohet, do te permbushe edhe kerkesat qe aplikohen per kete anije ne zonat dhe rajonet e pershkruara ne aneksin 2.
2. Nje port qe ndodhet ne vijen e kufirit ndermjet dy zouave ose rajoneve do te konsiderohet si brenda zones ose rajonit nga apo ne te cilen anija mberrin ose largohet.

Neni 12

Zhytja e anijes

1. Pavec rasteve te parashikuara ne paragrafet 2 dhe 3 te ketij neni, vijat perkatese te ngarkeses ne anet e anijes, qe i korrespondojne stines se vitit dhe zones ose rajonit ne te cilin mund te ndodhet anija, nuk do te jene te zhytura ne asnje moment te ndodhjes se anijes ne det, gjate udhetimit ose ne mberritje.
2. Kur nje anije eshte ne uje te embel me densitet sa njesia, vija perkatese e ngarkeses mund te zhytet sa sasia e lejuar per uje te embel e treguar ne certifikaten nderkombetare te vijes se ngarkeses (1966).
Kur densiteti eshte i ndryshem nga njesia, do te lejohet nje kuote ne proporcion me diferencen ndermjet 1.025 dhe densitetit faktik.
3. Kur nje anije largohet nga nje port qe ndodhet ne lume ose ujera te brendshme, ngarkimi me zhytje me te madhe do te lejohet ne varesi te peshes se lendes djegese dhe materialeve te tjera qe do te kerkohen per konsum ndermjet pikes se nisjes dhe mberritjes.

Neni 13

Survejimi, inspektimi dhe marketimi

Survejimi, inspektimi dhe marketimi i anijeve, persa i perket forcimit te kerkesave te kesaj Konvente dhe dhenies se perjashtimeve sipas saj, do te kryhet nga ofieeret e administrates. Administrata mundet megjithate, t'ia besoje survejimin, inspektimin dhe marketimin ose survejuesve te emeruar per kete qellim ose organizatave te njohura prej saj. Ne cdo rast administrata ne fjale garanton plotesisht teresine dhe vlefshmerine e survejimit, inspektimit dhe marketimit.

Neni 14

Survejimet dhe inspektimet fillestare e periodike

1. Nje anije mund te jete subjekt i survejimeve dhe inspektimeve sic specifkohet me poshte:
 - a) Survejim perpara se anija te futet ne shfrytezim, i cili perfshin nje inspektim te plote te struktures dhe pajisjeve te saj persa mbulon kjo Konvente. Ky survejim do te jete i tille qe te siguroje se konstruksioni, materiali dhe traret te permbushin plotesisht kerkesat e kesaj Konvente.

b) Survejimi periodik ne intervalet e percaktuara nga administrata, por qe nuk i kalon 5 vjetet, i cili do te jete i tille qe te siguroje se struktura, pajisjet, sistemi, materiali dhe traret te jene ne perputhje me kerkesat e kesaj Konvente.

c) Inspektimi periodik brenda tre muajve para ose prapa dates se inspektimit vjetor, per te siguruar se nuk jane bere ndryshime te tilla ne skaf apo superstruktura, qe te influencojne ne llogaritjet qe percaktojne pozicionin e vijes se ngarkeses dhe per te siguruar mirembajtjen ne gjendje normale te instalimeve dhe pajisjeve per:

1. mbrojtjen e daljeve

2. grilave mbrojtese

3. portat

4. mjetet e hyrjes ne ambientet e ekuipazhit

2. Inspektimet periodike referuar ne paragrafin 1 te ketij neni do te shenohen ne certifikaten nderkombetare te vijes se ngarkeses (1966) ose ne certifikaten nderkombetare te perjashtimit te vijes se ngarkeses, qe i leshohet nje anijeje te perjashtuar sipas paragrafit 2 te nenit 6 te kesaj Konvente.

Neni 15

Ruajtja e gjendjes pas survejimit

Pas perfundimit te cdo lloj survejimi te anijes sipas nenit 14, asnje ndryshim nuk mund te behet ne struktura, pajisje, sisteme, materiale ose trare qe prek ky survejim, pa sanksionimin e administrates.

Neni 16

Dhenia e certifikatave

1. Certifikata nderkombetare e vijes se ngarkeses (1966) i jepet cdo anijeje, e cila eshte survejuar dhe shenuar ne perputhje me kete Konvente.

2. Certifikata nderkombetare perjashtimi i vijes se ngarkeses (1966) i jepet cdo anijeje, se ciles i eshte dhene perjashtim sipas dhe ne perputhje me paragrafin 2 ose 4 te nenit 6.

3. Keto certifikata do te jepen nga administrata ose nga persona, ose organizata te autorizuar nga ajo. Ne cdo rast, administrata merr pergjegjesi te plote per certifikaten.

4. Pavaresisht nga kerkesa te tjera te Konventes, cdo certifikate nderkombetare e vijes se ngarkeses qe eshte korrente kur kjo Konvente vjen ne fuqi persa i perket qeverise se shtetit, flamurin e te cilit mban anija, mbeten te vlefshme per dy vjet ose deri ne dekadencen

e saj, cila te jete me pare. Mbas kesaj kohe, kerkohet nje certifikate nderkombetare e vijes

se ngarkeses (1966).

Neni 17

Dhenia e certifikates nga nje qeveri tjetër

1. Nje Qeveri Kontraktuese mundet me kerkesen e nje Qeverie tjetër Kontraktuese, te beje survejimin e nje anijeje dhe nese bindet qe kerkesat e kesaj Konvente permbushen,

te pajise ose te autorizojte pajisjen e anijes me nje certifikate nderkombetare te vijes se ngarkeses (1966) ne perputhje me Konventen.

2. Nje kopje e certifikates, nje kopje e raportit teurvejimit te perdorur per llogaritjen e bordit te lire dhe nje kopje e llogaritjeve do t'i transmetohen sa me pare qeverise kerkuese.

3. Nje certifikate e dhene ne kete menyre, duhet te permbaje nje deklarate me efektin se kjo eshte dhene me kerkesen e qeverise se shtetit, flamurin e te cilit ka ose do te kete anija dhe se do te kete te njejten njohje si nje certifikate e leshuar sipas nenit 16.

4. Nuk mund t'i leshohet certifikate nderkombetare e vijes se ngarkeses (1966) nje anijeje qe mban flamurin e nje shteti, qeveria e te cilit nuk eshte Qeveri Kontraktuese.

Neni 18

Forma e certifikatave

1. Certifikatat do te hartohen ne gjuhen ose gjuhete zyrtare te vendit qe i leshon. Nese gjuha e perdorur nuk eshte as anglisht, as frengjisht, teksti do te permbaje nje perkthim ne njeren nga keto gjuhe.

2. Forma e certifikates do te jete ajo e modeleve te dhena ne meksin

3. Paraqitja e tekstit te shtypur te certifikatave standarde do te riprodhohet ne menyre ekzakte ne certifikatat qe leshohen dhe ne kopjet e tyre te vertetuara.

Neni 19

Kohezgjatja e certifikates

1. Certifikata nderkombetare e vijes se ngarkeses (1966) leshohet per nje periudhe te specifikuar nga administrata, por qe nuk kalon 5 vjet nga data e leshimit.

2. Nese mbasurvejimit periodik te referuar ne paragrafin 1(b) te nenit 14, nje certifikate e re nuk mund t'i leshohet anijes perpara zhvlefesimit te certifikates se leshuar fillimisht, personi ose organizata qe kryenurvejimin mund te zgjase vlefshmerine e certifikates, per nje periudhe qe nuk i kalon 5 muaj. Kjo zgjatje do te pasqyrohet e kunderfirmosur ne certifikate dhe do te jepet vetem kur nuk ka pasur ndryshime ne strukture, pajisje, sistemim, materiale apo trare, te cilet te ndikojne ne bordin e lire te amjes.

3. Nje certifikate nderkombetare e vijes se ngarkeses (1966) do te anulohet nga administrata nese ekziston nje nga rrethanat e meposhtme:

a) jane bere ndryshime te tilla te materialeve te superstruktures ose te skafit, te cilat bejne te nevojshme percaktimin e nje bordi te lire te rritur;

b) instalimet dhe pajisjet e permendura ne nenparagrafin c te paragrafit 1 te nenit 14 nuk mbahen ne gjendje normale;

c) certifikata nuk eshte kundershenuar per te treguar se anija eshte e inspektuar, sic kerkohet ne nenparagrafin c te paragrafit 1 te nenit 14;

d) qendrushmeria e struktures se anijes eshte ulur ne nje shkalle te tille qe anija nuk eshte e sigurt.

4. Kohezgjatja e nje certifikate nderkombetare te vijes se ngarkeses (1966), leshuar nje anijeje nga administrata te perjashtuar nenparagrafin 2 te nenit 6 nuk duhet te kaloje 5 vjet nga data e leshimit. Kjo certifikate do te jete objekt i procedures se rinovimit,

kundershtimit dhe anulimit njesoj sic parashikohet per nje certifikate nderkombetare te vijes se ngarkeses (1966) ne kete nen.

Kohezgjatja e nje certifikate nderkombetare perjashtimi te vijes se ngarkeses (1966) leshuar nje anijeje te perjashtuar sipas paragrafit 4 te nenit 6 do te kufizohet ne udhetimin e vetem per te cilin eshte leshuar.

5. Certifikata e leshuar nje anijeje nga nje administrate do te pushoje se qeni e vlefshme me transferimin e anijes ne flamurin e nje shteti tjetër.

Neni 20

Pranimi i certifikates

Certifikatat e leshuara nen autoritetin e nje Qeverie Kontraktuese ne perputhje me kete Konvente do te pranohet nga Qeverite e tjera Kontraktuese dhe do te konsiderohet per cdo rast qe mbulohet nga kjo Konvente me te njejten fuqi si certifikate e leshuar prej tyre.

Neni 21

Kontrolli

11. Anijet qe mbajne nje certifikate te leshuar sipas nenit 16 ose 17 jane subjekt, kur ndodhen ne portet e Qeverive te tjera Kontraktuese, i kontrollit nga oficeret te autorizuar nga keto qeveri. Qeverite Kontraktuese do te sigurojne qe ky kontroll te ushtrohet perderisa eshte e arsyeshme dhe praktike, me qellim qe te verifikoje qe ne bordin e anijes ndodhet nje certifikate e vlefshme sipas kesaj Konvente. Nese ne bord ndodhet nje certifikate e vlefshme nderkombetare e vijes se ngarkeses (1966), ky kontroll do te kufizohet te percaktoje se:

a) anija nuk eshte e ngarkuar pertej kufijve te lejuar nga certifikata;

b) pozicioni i vijes se ngarkeses se anijes i korrespondon certifikates;

c) anija nuk eshte ndryshuar materialisht ne menyre te tille qe per nga pikepamja e problemeve qe shtrohen ne nenparagrafet a dhe b te paragrafit 3 te nenit 19, anija eshte dukshem e papershtatshme per te dale ne det pa rrezik per jeten e njeriut.

Nese ka nje certifikate te vlefshme nderkombetare te vijes se ngarkeses (1966) ne bord, qellimi i nje kontrolli te tille do te kufizohet te percaktoje permbushjen e kushteve te paraqitura ne kete certifikate.

2. Nese nje kontroll i tille ushtrohet ne nenparagrafin c te paragrafit 1 te ketij neni, ky kontroll do te ushtrohet per aq sa eshte e nevojshme te sigurohet qe anija nuk do te lundroje derisa mund te dale ne det pa rrezik per pasagjeret ose ekuipazhin.

3. Ne rastin e kontrollit qe sipas ketij neni jep rast per nderhyrje te cdo lloji, oficeri qe kryen kontrollin do te njoftoje menjehere me shkrim konsullin ose perfaqesuesin diplomatik te shtetit, flamurin e te cilit mban anija, per kete vendim dhe per te gjitha rrethanat ne te cilat nderhyrja ishte gjykuar si e nevojshme.

Neni 22

Privilegjet

Privilegjet e kesaj Konvente nuk mund te kerkohen ne favor te asnje anijeje, nese ajo nuk mban nje certifikate te vlefshme sipas kesaj Konvente.

Neni 23 Aksidentet

1. Çdo administrate merr persiper te kryeje investigimin e aksidenteve qe u ndodhin anijeve per te cilat eshte pergjegjese dhe qe jane subjekt i kerkesave te kesaj Konvente, kur gjykon se nje investigim i tille mund te ndihmoje per te percaktuar se cfare ndryshimesh te dobishme mund te behen ne Konvente.
2. Çdo Qeveri Kontraktuese merr persiper te furnizojë Organizaten me informacionet perkatese qe lidhen me konstatimet e ketyre investigimeve.
3. Raportet ose rekomandimet e Organizates, te cilat bazohen ne keto informacione, nuk do te zbulojne identitetin apo nacionalitetin e anijeve ne fjale dhe ne asnje forme nuk do te fiksojne apo te nenkuptojne pergjegjesi mbi asnje anije ose person.

Neni 24 Traktate dhe Konventa te meparshme

1. Te gjitha traktatet e tjera dhe marreveshjet qe lidhen me ceshtjet e vijave te ngarkesave ne fuqi aktualisht ndermjet Qeverive Pale te kesaj Konvente, do te vazhdojne te kene efekt te plote ne afatet e veprimit te tyre, ne rastin:
 - a) e anijeve, per te cilat kjo Konvente nuk vepron;
 - b) e anijeve, per te cilat kjo Konvente vepron, por per ceshtje qe ajo nuk shprehet.
2. Megjithate, ne ate mase qe keto traktate, konventa ose marreveshje kontradiktojne me dispozitat e kesaj Konvente, keto te fundit jane percaktuese.

Neni 25 Rregulla te vecanta te formuluar ne baze marreveshjeje

Kur ne perputhje me kete Konvente rregulla te vecanta formulohen me marreveshje ndermjet te gjitha ose te disa prej Qeverive Kontraktuese, keto rregulla do t'i komunikohen Organizates per qarkullim te gjitha Qeverive Kontraktuese.

Neni 26 Komunikimi i informacionit

1. Qeverite Kontraktuese marrin persiper te komunikojne me Organizaten dhe te depozitojne prane saj:
 - a) Nje numer te mjaftueshem formatesh te certifikatave te emetuara prej tyre ne dispozicion te kesaj Konvente, per qarkullim Qeverive Kontraktuese.
 - b) Tekstin e ligjeve, dekretive, urdhrave, rregullave dhe instrumenteve te tjera, te cilat jane promulguar per probleme te ndryshme te kesaj Konvente.
 - c) Nje liste te agjencive joqeveritare, te cilat jane te autorizuar te veprojne ne emrin e tyre ne administrimin e ceshtjeve te vijes se ngarkeses, per qarkullim Qeverive Kontraktuese.
2. Çdo Qeveri Kontraktuese pranon te vere ne dispozicion standardet e saj te qendrushmerise nese kerkohen nga nje Qeveri tjeter Kontraktuese.

Neni 27

Nenshkrimi, pranimi dhe bashkimi

1. Kjo Konvente do te mbetet e hapur per nenshkrim per ire muaj nga 5 prilli 1966 dhe me pas do te mbetet e hapur per bashkim. Qeverite e shteteve anetare te Kombeve te Bashkuara ose te ndonjeres nga agjencite e specializuara, ose te Agjencise Nderkombetare te Energjise Atomike, ose Pale te Statutit te Gjyqit Nderkombetar te Drejtesise mund te behen Pale te Konventes duke:

- a) nenshkruar pa rezerve, persa i perket pranimit,
- b) nenshkruar subjekti i pranimit i ndjekur nga pranimi,
- c) bashkim.

2. Pranimi ose bashkimi kryhet me depozitimin e nje instrumenti pranimi ose bashkimi ne Organizate, e cila informon te gjitha qeverite qe kane nenshkruar Konventen ose bashkuar ne te, per cdo pranim te ri ose bashkim, si dhe daten e depozitimit.

Neni 28

Ardhja ne fuqi

1. Kjo Konvente do te vije ne fuqi 12 muaj pas dates ne te cilen jo me pak se 15 qeveri te shteteve, qe perfshijne 7 shtete me jo me pak se 1 milion ton bruto anije, kane shpenzuar pa rezervim per sa i perket pranimit ose kane depozituar instrumente te pranimit ose aksedimit ne perputhje me nenin 27. Organizata do te informoje te gjitha qeverite qe kane nenshkruar ose akseduar ne kete Konvente per daten ne te cilen ajo hyn ne fuqi.

2. Per qeverite te cilat kane depozituar nje instrument pranimi per ose aksedimi ne Konvente gjate 12 muajve te permendur ne paragrafin (1) te ketij neni, pranimi ose aksedimi ekzekutohet me ardhjen ne fuqi te kesaj Konvente ose 3 muaj pas depozitimit te instrumentit cilado qe te jete data e mepasme.

3. Per qeverite te cilat kane depozituar nje instrument pranimi per ose aksedimi ne kete Konvente mbas dates ne te cilen ajo vjen ne fuqi, Konventa vjen ne fuqi 3 muaj mbas depozitimit te instrumentit cilado qe te jete data e mevonshme.

4. Mbas dates ne te cilen te gjitha masat qe kerkohen per te sjelle nje ndryshim te kesaj Konvente ne fuqi jane plotesuar ose te gjitha pranimet shikohen si te dhena ne nenparagrafin (b) te paragrafit 2 te nenit 29 ne rast ndryshimi me pranimin unanim, cdo instrument pranimi ose aksedimi i depozituar do te shikohet si ne perputhje me Konventen si eshte ndryshuar.

Neni 29

Ndryshimet

1. Kjo Konvente mund te ndryshohet sipas cilesdo nga procedurat e specifikuara ne

paragrafet e meposhtem.

2. Ndryshime mbas shqyrtimeve perbrenda Organizates:

a) Çdo ndryshim propozuar nga nje Qeveri Kontraktuese do t'i paraqitet Sekretarit te

Pergjithshem te Organizates, i cili e qarkullon ate me pas tek te gjithe anetaret e Organizates dhe Qeverite Kontraktuese te pakten 6 muaj para ndryshimit.

b) Çdo ndryshim i propozuar dhe i qarkulluar si me siper do t'i referohet Komitetit te Sigurise Detare te Organizates per shqyrtim.

c) Qeverite Kontraktuese te shteteve anetare ose jo te Organizates do te kene te drejten te marrin pjese ne punimet e Komitetit te Sigurise Detare per shqyrtimin dhe adaptimin e ndryshimeve.

d) Ndryshimet do te adaptohen me nje shumice prej dy te tretave te Qeverive Kontraktuese qe marrin pjese dhe votojne ne Komitetin e Sigurise Detare te zgjeruar si jepet ne nenparagrafin (c) te ketij paragrafi (ketu me poshte referuar si "Komiteti i zgjeruar i Sigurise Detare" me kushtin qe te pakten nje e treta e Qeverive Kontraktuese te jete prezent ne Kohen e votimit.

e) Ndryshimet e adaptuara ne perputhje me nenparagrafin (d) te ketij paragrafi do t'u komunikohen, nga Sekretari i Pergjithshem i Organizates, te gjitha Qeverive Kontraktuese per pranim.

f) Ndryshimi ne nje nen te Konventes do te quhet i pranuar ne daten ne te cilen eshte pranuar nga dy te tretat e Qeverive Kontraktuese.

Ndryshimi ne nje aneks do te konsiderohet si i pranuar:

- ne perfundimin e dy vjeteve ne te cilen ky i eshte komunikuar Qeverive Kontraktuese per pranim;

- ne perfundim te nje periudhe te ndryshme, e cila nuk do te jete me pak se nje vit, nese keshtu vendoset ne Kohen e adaptimit te tij nga nje shumice prej dy te tretave te Qeverive Kontraktuese qe jane prezente dhe votojne ne Komitetin e zgjeruar te Sigurise Detare. Pavaresisht nga kjo, nese brenda periudhes se specifikuar ose me shume se nje e treta e Qeverive Kontraktuese, ose nje numur i tille Qeverish Kontraktuese qe flotat e tyre tregtare te perbejne jo me pak se 50% te tonazhit bruto te flotave tregtare te te gjitha Qeverive Kontraktuese, njoftojne Sekretarin e Pergjithshem se ato kundershtojne ndryshimin, ky ndryshim do te konsiderohet se nuk eshte pranuar.

g) Ndryshimi i nje neni te Konventes do te hyje ne fuqi ne rastin e atyre Qeverive Kontraktuese qe e Kane pranuar ate, 6 muaj mbas dates ne te cilen ky ndryshim konsiderohet si i hyre ne fuqi dhe ne rastin e asaj Qeverie Kontraktuese qe e pranon ate mbas kesaj date, 6 muaj mbas dates se pranimit te kesaj qeverie.

i) Ndryshimi ne nje aneks do te hyje ne fuqi per te gjitha Qeverite Kontraktuese, pervec atyre qe Kane paraqitur objeksione per ndryshimin sipas pikes (f) te ketij paragrafi dhe qe nuk i Kane terhequr keto objeksione, 6 muaj mbas dates ne te cilen ky ndryshim quhet i pranuar. Megjithate, perpara dates se caktuar te hyrjes ne fuqi, cilado nga Qeverite Kontraktuese mund te jape njoftimin prane Sekretarit te Pergjithshem te Organizates se e perjashton veten nga venia ne Veprim e atij ndryshimi per nje periudhe jo me te gjate se nje vit nga data e hyrjes se tij ne fuqi, ose per nje periudhe aq me te gjate, sic mund te vendoset nga nje shumice prej dy te tretave te Qeverive Kontraktuese prezente dhe votuese ne Komitetin e zgjeruar te Sigurise Detare ne kohen e adaptimit te ndryshimit.

3. Ndryshimi nga nje konference:

a) Me kerkesen e nje Qeverie Kontraktuese te mbeshtetur nga te pakten nje e treta e Qeverive Kontraktuese, Organizata do te therrase nje konference te Qeverive Kontraktuese per te konsideruar ndryshimet ne kete Konvente.

b) Çdo ndryshim i adaptuar nga nje konference e tille me nje shumice sa dy te tretat e Qeverive Kontraktuese prezente dhe votuese, do t'u komunikohet nga Sekretari i Pergjithshem i Organizates, te gjitha Qeverive Kontraktuese per pranim.

c) Nese Konferenca nuk vendos ndryshe, ndryshimet do te konsiderohen si te pranuar dhe do te hyjne ne fuqi ne perputhje me procedurat e specifikuar respektivisht ne nenparagrafet (2)(f) dhe (2)(g) te ketij neni, me kusht qe referimet ne keta paragrafe Komitetit te zgjeruar te Sigurise Detare te kuptohen si referime konferences.

4. a) Nje Qeveri Kontraktuese, e cila ka pranuar nje ndryshim ne nje aneks qe ka hyre ne fuqi, nuk do te jete e detyruar te shtrihe perfitimet e kesaj Konvente per sa i perket certifikatave te leshuara nje anijeje qe ka te drejten e mbajtjes se flamurit te nje shteti, Qeveria e te cilit, ne zbatim te klauzolave te nenparagrafit (2)(f) te ketij neni, nuk ka pranuar ndryshimet dhe nuk e ka terhequr kete mospranim, por vetem ne ate shkalle qe keto certifikata kane te bejne me ceshtje qe mbulohen nga ndryshimi ne fjale.

b) Nje Qeveri Kontraktuese, e cila ka pranuar nje ndryshim ne nje aneks, i cili ka hyre ne fuqi, do te shtrihe perfitimet e kesaj Konvente persa i perket certifikatave te leshuara nje anijeje qe ka te drejten e flamurit te nje shteti, qeveria e te cilit, ne zbatim te klauzolave te nenparagrafit (2)(g) te ketij neni, ka njoftuar Sekretarin e Pergjithshem te Organizates se e perjashton veten nga venia ne veprimi e ketij ndryshimi.

5. Nese nuk jepet shprehimisht ndryshe, çdo ndryshim ne kete Konvente, i bere sipas ketij neni, qe lidhet me strukturen e anijes, do te zbatohet vetem per anijet, kili i te cilave eshte shtruar ose qe jane ne nje faze te ngjashme te ndertimit ne ose pas dates, ne te cilen ndryshimi hyn ne fuqi.

6. Çdo deklarate e pranimit ose kundërshtimit të një ndryshimi ose çdo njoftim i dhënë sipas nenparagrafit (2)(g) te ketij neni do t'i dorezohet e shkruar Sekretarit te Pergjithshem te Organizates, i cili do te njoftoje te gjitha Qeverite Kontraktuese per çdo depozitim te tille dhe per daten ne te cilen nje ndryshim i tille hyn ne fuqi.

Neni 30

Denoncimi

1. Kjo Konvente mund te denoncohet nga cdo Qeveri Kontraktuese ne cdo kohe mbas kohes se ekspertimit prej 5 vjetesh nga data, ne te cilen Konventa vjen ne fuqi per ate qeveri.

2. Denoncimi do te kryhet nepermjet nje njoftimi me shkrim adresuar Organizates, e cila do te njoftoje te gjitha Qeverite e tjera Kontraktuese per cdo njoftim te tille dhe per daten e marrjes se tij.

3. Nje denoncim hyn ne veprim mbas nje viti ose mbas nje periudhe te tille aq me te gjate sic mund te specifikohet ne noten, mbas marrjes se saj nga Organizata.

Neni 31

Pezullimi

1. Ne rast armiqesish ose rrethanash te tjera te jashtezakonshme, te cilat prekin interesat vitale te shtetit, qeveria e te cilit eshte Qeveri Kontraktuese, kjo qeveri mund te pezulloje funksionimin e tere Konventes ose te cdo pjese te saj. Qeveria pezulloese do te njoftoje menjehere per cdo pezullim te tille Organizaten.

2. Nje pezullim i tille nuk do te perjashtojte Qeverite e tjera Kontraktuese per ceshtje qe kane te bejne me te drejten e kontrollit sipas kesaj Konvente mbi anijet e qeverise pezulluese kur anije te tilla jane brenda porteve te tyre.
3. Qeveria pezulluese mund ne cdo kohe te perfundoje nje pezullim te tille dhe do te njoftojte menjehere me shkrim per nje perfundim te tille.
4. Organizata do te njoftojte te gjitha Qeverite Kontraktuese per cdo pezullim ose perfundim te tij sipas ketij neni.

Neni 32 Territoret

1. Kombet e Bashkuara qe jane autoriteti administrues per nje territor ose çdo Qeveri Kontraktuese pergjegjese per marredheniet nderkombetare te nje territori, do te konsultohen me nje territor te tille sa me pare qe te jete e mundur, ne perpjekje per te shtrire kete Konvente mbi kete territor dhe mund qe ne cdo kohe me ane te nje njoftimi me shkrim te Organizates te deklarojne se kjo Konvente do te shtrihet mbi kete territor. Konventa ne fjale do te shtrihet mbi kete territor nga data e marrjes se ketij njoftimi ose nga ajo date sic mund te jete specifikuar ne njoftim.
2. Kombet e Bashkuara ose cdo Qeveri Kontraktuese, e cila ka bere nje deklarate sipas nenparagrafit (a) te paragrafit (1) te ketij nelli, ne cdo kohe mbas ekspirimit te nje periudhe 5-vjecare nga data e shtrirjes se Konventes ne kete menyre mbi nje territor, mund qe me ane te njoftimit me shkrim te Organizates te deklaroje se kjo Konvente do te pushoje se qeni ne fuqi ne territorin e permendur ne njoftim. Kjo Konvente do te pushoje se zbatuari ne territore te permendura ne nje njoftim te tille nje vit ose aq sa te jete specifikuar ne te, pas marrjes se njoftimit.
3. Organizata do te njoftojte te gjitha Qeverite Kontraktuese mbi shtrirjen e kesaj Konvente ne territore te paragrafit (1) te ketij neni dhe perfundimin e cdo shtrirjeje sipas paragrafit (2), duke shprehur ne cdo rast daten, nga e cila kjo Konvente ka ose do te pushoje keshtu se vepruari.

Neni 33 Regjistrimi

1. Kjo Konvente do te depozitohet prane Organizates dhe Sekretari i Pergjithshem i Organizates, do te transmetojte kopje te certifikuara te verteta te saj, te gjitha qeverive nenshkruese dhe te gjitha qeverive qe aksedojne ne te.
2. Sapo kjo Konvente hyn ne fuqi do te regjistrohet nga Organizata ne perputhje me nenin 102 te Çarterit te Kombeve te Bashkuara.

Neni 34 Gjuhet

Kjo Konvente eshte ne nje kopje te vetme ne gjuhet angleze dhe franceze, te dyja tekstet njesoj autentike. Perkthime zyrtare ne rusisht dhe spanjisht do te pergatiten dhe depozitohen bashke me origjinalin e nenshkuar.